



STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ E Events” shpk

Sot me date 23.09.2024 (dymije e njezet e kater) ne cilesine e ortakeve themelues

Zj, Irena Pogaçe e bija e Leonardit, lindur me 16.03.1988 me Nr,Identifikimi I85316060T, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Dhe

Shoqëria “Art & Tourism Development Group”sh.p.k , person juridik shqiptar rregjistruar më datë 05.01.2018, me NIPT L83705802U dhe me seli në Sarandë , Zona “Hoteleri Turizëm , Zona Kadastrale 8642 e përfaqesuar nga administratori i saj, Z.Ermal Muço.

Palet e lartpermendura me vullnetin e plote dhe te lire kane vendosur te nenshkruajne Statutin e meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.

TITULLI I

FORMA dhe PERSONALITETI JURIDIK , EMERTIMI , OBJEKTI , SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1 – Forma dhe personaliteti juridik

1.1. Shoqëria "E Events" sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.

1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3. Statuti i shoqërisë është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

1.4. Me vendim të Asamblese së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin e saj juridik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.

1.5 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Ushtrimin e aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me certifikatën NIPT NGA Qendra Kombëtare e Biznesit.

NENI 2 – Emertimi

Shoqëria tregtare është vendase dhe quhet : “E Events” shpk

NENI 3 – Objekti

Objekti i Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:

3.1 Shoqëria ka objekt planifikimin dhe organizimin e dekoreve event design, produksion-menaxhim-kordinim eventesh sociale, koncerte, korporata dhe dasma.

NENI 4 - Selia

4.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Tirane, Rezidenca “Kodra e Diellit 2” Godina A2/3 me Nr.Pasurie:125/6+1-57, Zona Kadastrale 3292.

4.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe / ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe / ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnere apo Aksionare pjesëmarrës.

NENI 5 - Kohezgjatja

5.1 Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaket e Shoqërisë mund të vendosin të kufizojnë kohezgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

TITULLI II

KAPITALI I SHOQËRISË— ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT— TRANSFERIMI I KAPITALIT

NENI 6 – Kapitali i Shoqërisë

6.1 Kapitali i shoqërisë do të jetë 10 000 (dhjetë mijë) leke,

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme :

1.Ortaku themelues **Zj. Irena Pogaçe** , zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4500 leke, që përbejnë 45 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2.Ortaku themelues **Shoqëria “Art & Tourism Development Group”sh.p.k** , person juridik shqiptar regjistruar më datë 05.01.2018, me NIPT L83705802U dhe me seli në Sarandë , Zona “Hoteleri Turizëm , Zona Kadastrale 8642 e përfaqësuar nga administratori i saj, Z.Ermal Muço, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5500 leke , që përbejnë 55% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar eshte i nenshkruar plotësisht nga ortaket themelues ne masën 100%. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme të palujtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë;

NENI 7 – Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim te Asamblesë së Ortakëve. Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar prej tyre.

7.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me vleren nominale te kuotes se kapitalit të zotëruar prej tyre.

NENI 8 – Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :

- a) Kontributi ne kapitalin e shoqerise,
- b) Shitblerjes,
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter e parashikuar me ligj

TITULLI III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9 – Organi vendimarrës

9.1 Asambleja e ortakeve është organi i vetem i vendimë marrjes i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi vendimë marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku, vendos për ceshtje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- j) Ndryshimi i statutit
- k) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit
- l) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- m) Investime
- n) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- o) Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhenien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhenien me qera të aseteve të shoqërisë;
- p) Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretet;
- r) Miraton strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikën dhe nivelin e pagave dhe shpërblimeve për çdo vend pune në shoqëri;

9.2 Asambleja thirret nga Administratori ose nga ortakët e shoqërisë, nepermjet një njoftimi me shkrim. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i dërgohet të gjithë subjekteve të interesuar, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Megjithatë janë të vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë që nuk janë thirrur si më sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe nëse në mbledhje asiston Administratori dhe eksperti kontabel i miratuar (nëse ben pjesë në strukturën e shoqërisë).

Në Asamble duhet të marrin pjesë të gjithë ata që figurojnë të regjistruar në librin e ortakëve. Ortaku ka të drejtën e votes në Asamble në proporcion me kuotën që zoteron në kapitalin e shoqërisë. Ortaku mund të përfaqësohet vetë, ose nepermjet një personi të pajisur me prokurë, i cili nuk duhet të jetë administratori, apo ekspert kontabel i autorizuar ose vartës i vetë shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër të kontrolluar prej saj. I takon Administratoreve të verifikojë të drejtën e pjesëmarrjes për ortakun.

Asambleja drejtohet nga Administratori dhe në mungesë të tij, pjesëmarrësit në mbledhje, me shumicë absolute të kapitalit prezent në sallë, zgjedhin një drejtues.

NENI 10 – Kuorumi dhe Vendimarja

10.1 Kuorumi

Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë përqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.


10.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat per permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligi apo statuti.

Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjetë përqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit ose krijimin apo emetimin e aksioneve te reja ose garancive te tjera ose dhenien e cdo te drejte per nenshkrimin apo konvertimin e cdo instrumenti ne aksione apo garanci;
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividendeve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividendeve;



(d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likujdimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;

(e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likujdimin e shoqerise;

(f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;

(g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara.

NENI 11 - Administrimi


Administrator i shoqerise "E Event: shpk, caktohet ortakut themelues Zj. Irena Pogaçe, i cili emerohet per nje afat 3 vjecar me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 12- Kompetencat e Administratorit

- Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise;
- Te zbatoje politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Ortakeve;
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare perpara te treteve;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- Te pergatise dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise;
- Te pergatise buxhetin vjetor te shoqerise.
- Te pregatise propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t'i paraqese keto dokumente perpara Asamblese per miratim;
- Te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- Te kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kornbetare te Regjistrimit;
- Te raportoje perpara Asamblese ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- Te propozoje dhe ti paraqesi Asamblese per miratim strukturen organizative te shoqerise, rregulloren e brendeshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;
- Te mos kryeje veprimtari konkurruese (ndalimi i konkurences) me veprimtarie qe kryen shoqeria.
- Administratori ka te drejte te rimbursohet per shpenzimet e bera per arsye pune si dhe te drejten e nje rroge mujore te aprovuar nga Asambleja.

Administratori mund te kryeje edhe detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut. Ata mund te vene ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, duke kryer operatione bankare, ketu perfshire edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rryedhese, nenshkrimin dhe xhirirnin e ceqeve, realizimin e



terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher xhirimi, tituj .krediti, paradhënie krediti.

Administratoret e shoqerise, per nevojat e ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, kane te drejte te marrin ne pune specialiste me shtetesi te ndryshme duke lidhur Kontraten sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Punes ne fuqi, dhe shtesat e mepasme plotesuese te tij dhe me Ligjin "Per Sigurimet shoqerore" si dhe ne perputhje me rregullat teknike dhe te disiplines profesionale te caktuara nga ana e punedhënesit.

NENI 13 – VITI FINANCIAR

13.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

13.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

NENI 14 - Prishja-Ndarja-Bashkimi

14.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

14.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

NENI 15 – Likuidimi

15.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

15.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

15.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

15.4 Me likuidimin e kreditorëve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

TITULLI VII

TE NDRYSHME

NENI 16 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreshjeve

Gjuha Shqipe konsiderohet si gjuhe e Ortakeve.


Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht ne te kundert kompetente eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI X. DISPOZITA TE FUNDIT

Ky Statut u hartua ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKET THEMELUES

Irena POGAÇE



**Art & Tourism
Development
Group” sh.p.k**

Perfaqesues Ligjor

Z. Ermal Muço



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " E Events" shpk

Sot me date 23.09.2024 nga ne themeluesit :

Zj, Irena Pogaçe e bija e Leonardit, lindur ne Tiranë me 16.03.1988 me Nr. Identifikimi I85316060T, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Dhe

Shoqëria "Art & Tourism Development Group" sh.p.k, person juridik shqiptar regjistruar më datë 05.01.2018, me NIPT L83705802U dhe me seli në Sarandë, Zona "Hoteleri Turizëm", Zona Kadastrale 8642 e përfaqësuar nga administratori i saj, Z. Ermal Muço.

Shoqeria "E Events" Shpk qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet "Shoqeria" eshte person juridik shqiptar dhe eshte krijuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 1

Themelimi, forma dhe emertimi

Emri i shoqerise eshte " E Events " shpk. Shoqeria eshte themeluar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacioni shqiptar.

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar te cituar dhe Statutin e saj.

Neni 2

Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen : Rezidenca "Kodra e Diellit 2", Godina A2/3 me Nr.Pasurie:125/6+1-57, Zona Kadastrale 3292.

Ne baze te ligjit shoqeria mund te hape apo te krijojë seli dytesore, dege, filiale, agjenci, zyra perfaqesie si ne Shqiperi dhe jashte saj.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar.

Neni 4

Objekti

Objekti i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarite e meposhtme:

Shoqeria ka objekt planifikimin dhe organizimin e dekoreve event design, produksion-menaxhim-kordinim eventesh sociale, koncerte, korporata dhe dasma

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërise do të jete 10 000 (dhjete mije) leke,

Pjesëmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqërise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :

1.Ortaku themelues **Zj. Irena Pogaçe** , zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 4500 leke, qe perbejne 45 % te kapitalit themeltar te shoqërise.

2.Ortaku themelues **Shoqëria “Art & Tourism Development Group”sh.p.k** , person juridik shqiptar regjistruar më datë 05.01.2018, me NIPT L83705802U dhe me seli në Sarandë , Zona “Hoteleri Turizëm , Zona Kadastrale 8642 e përfaqesuar nga administratori i saj, Z.Ermal Muço, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 5500 leke , qe perbejne 55% te kapitalit themeltar te shoqërise.

Neni 6

Asambleja e Ortakeve

Asambleja e ortakeve është organi vendimëmarres i shoqërise që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 7

Administratori

Shoqëria do te administrohet nga nje administrator, i cili mund te zgjidhet brenda ose jashte bashkesise se ortakeve. Administratori eshte perfaqesuesi ligjor i shoqërise dhe e perfaqeson ate ne marredhenie me te tretet.

Administrator i shoqërise do te jete ortaku themelues, **Zj, Irena Pogaçe** e bija e Leonardit, lindur ne Tirane, me 16.03.1988 me Nr. Identifikimi I85316060T, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratori zgjidhet per nje periudhe 3 (tre) vjecare dhe eshte i rizgjedhshem.

Neni 8

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

Neni 9

Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Gjuha Shqipe konsiderohet si gjuhe e Ortakeve.

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve fillimisht do të zgjidhen në mënyrë të brendshme dhe më pas në të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI X. DISPOZITA TE FUNDIT

Ky Statut u hartua në 4 (**kater**) kopje në gjuhën shqipe.

Ky akt themelimi hartohet në tre ekzemplare origjinale në gjuhën Shqipe, një prej të cilëve depozitohet në QKB nga Asambleja e Ortakeve.

ORTAKET THEMELUES

Irena POGACE



**Art &
Tourism Development
Group” sh.p.k**

Perfaqesues Ligjor

Z. Ermal Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER DONIKA A. GJINI



V2024052970476161594

DATE 24/09/2024
NR REP 5751

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, ne Tirane para meje Notere DONIKA A. GJINI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Emin Duraku", P.Av.Vjeter, Nr.6, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUESIT:

Irena Pogaçe, atësia Leonard, amësia Kristina, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Durrësit; Nd. 226/1; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 16/03/1988, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037003104 dhe nr. personal I85316060T .

Ermal Muço, atësia Luan, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Budi Pall 58/2/18; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, lindur më 05/03/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035726143 dhe nr. personal I60305009F .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "*Statut dhe Akt Themelimi te Shoqerise me Pergjegjesi et Kufizuar "E Events"shpk*", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "*Për Noterinë*", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave Personale*", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER
DONIKA A. GJINI